



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 82 Datë 23.12.2022

PER

MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFAT MESËM (PBA) 2024-2026 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2024.

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin Nr.10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33, Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, datë 29.03.2012 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat-Mesem”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”,

VENDOSI

1. Të miratojë Kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA 2024-2026) dhe të buxhetit vjetor 2024, bashkangjitur këtij Vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55/6, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS
DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

P/VENDIM

Nr. 78 Datë 20 . 12 . 2022

PER

MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFAT MESËM (PBA) 2024-2026 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2024.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin Nr.10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) , ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33, Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, datë 29.03.2012 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat-Mesem”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Kukës për:

MIRATIM:

1. Kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA 2024-2026) dhe të buxhetit vjetor 2024, bashkangjitur këtij Projekt Vendimi.

KRYETARI
Safet GJICI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

PER

MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFAT MESËM (PBA) 2024-2026 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2024.

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 te miratuar me date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin Nr.10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) , ligjin Nr.68/2017, te miratuar me date 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” neni 33, Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.8, datë 29.03.2012 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat-Mesem”, udhezimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues Nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transfera e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”

“Per miratim e Kalendarit te aktiviteve të Programit Buxhetor Afat-Mesëm (PBA) për vitet 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024”

Ne referim te nenit 33 te ligjit Nr.68/2017, si dhe kuader te ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore, Kryetari i Bashkise ka detyrimin ligjor qe te pergatise dhe dergoje për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afat-mesëm dhe të buxhetit vjetor.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi

Ne përgatitjen e kalendarit janë marrë në konsiderate disa komponente kryesor te MFK-së, si me poshtë vijon:

1. Qeverisja

Qeverisja përfaqëson mënyrën në të cilën njësitë drejtohen dhe kontrollohen. Ajo përcakton shpërndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive, përcakton rregullat dhe procedurat për marrjen e vendimeve të përbashkëta, duke përfshirë procesin nëpërmjet të cilit vendosen objektivat e njësisë, dhe siguron mënyrat e arritjes së këtyre objektivave dhe performancën monitoruese.

2. Buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore:

Sipas nenit 41 të ligjit Nr.139/2015, përcaktohet se: Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore

Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:

- a. Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh, përfshirë shlyerjen e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b. Të gjitha transfertat e kushtëzuara, të parashikuara për t'u marrë nga qeverisja qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore.
- c. Të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për t'u siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë bashkisë nga çfarëdolloj burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifatat, vlerësimet, gjobat, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes;
- d. Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse;
- e. Parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:
 - i) qëllimin e investimit;
 - ii) planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit;
 - iii) shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret, si dhe një preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit;
- f. Objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Ne piken 9 të udhezimit të Ministrisë së Financave Nr.8, datë 29.03.2012, përcaktohet: Këshilli i njësive të qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton buxhetin vjetor për njësitë e qeverisjes vendore. Sipas ligjit për MSB-në, "Nëpunësit Autorizues" (NA-të) janë nëpunës të

nivelit të lartë të manxhimit të NjQP, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe AB të buxheteve të tyre dhe janë përgjegjës para NPA.

3. Programi Buxhetor Afat-Mesëm:

Titullari i njesise ka përgjegjësi për miratimin e kerkesave buxhetore për njesinë e qeverisjes së përgjithshme që mbulon në përputhje me procedurat dhe kërkesat e përshkruara në këtë udhëzim si dhe brenda taveve të shpenzimeve dhe afateve të përcaktuara në udhëzimet vjetore të përgatitjes së kerkesave buxhetore, si dhe për të garantuar që vendimet në lidhje me politikën, planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore realizohen në kohë dhe në përputhje me funksionet e njesisë.

Ne referim te pikes 61 te udhezimit te MF-se Nr.8, date 29.03.2012, titullari i njesise vendore miraton kalendarin e përgatitjes së kerkesave buxhetore për njesinë përkatëse i cili përmban datat kryesore për:

- a. *Vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për tre vitet e ardhshme;*
- b. *Përgatitjen e kerkesave buxhetore për fazen e pare dhe te dyte te kerkesave buxhetore afatmesme;*
- c. *Dërgimin për miratim të programit buxhetor afatmesëm dhe projekt-buxhetin vjetor në Këshill.*

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (*i ndryshuar*) dhe në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së PBA, kështu buxheti vjetor është viti i parë i PBA-së.

4. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli:

Sistemi i MFK-së duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht me dispozitat e ligjit të MFK dhe ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (*i ndryshuar*) dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar (transparenca, efikasiteti, efektshmëria dhe ekonomia).

Titullarët e Njësive Publike Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave, identifikimin në të gjitha nivelet e njësive të risqeve që kanë ndikim në përmbushjen e tyre, dhe për krijimin e një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të MFK-së në përputhje me kërkesat e ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve

5. Grupi i Menaxhimit Strategjik:

Çdo titullar i njësive publike duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësive. GMS është një element integral i përgjegjëshmërisë dhe qeverisjes publike. GMS luan një rol kyç për integritetin të informacionit financiar të njësive publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike.

6.Proçesi i menaxhimit të riskut:

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Menaxhimi i riskut mund të thuhet se është po aq i zhvilluar sa janë edhe aktivitetet e kontrollit. Aktivitetet e kontrollit përqëndrohen jo vetëm në çështjet e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, por edhe në çështje që lidhen me dhënien e sigurisë së objektivat të njesise.

7.Raportimi mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit:

Njësitë publike raportojnë mbi funksionimin e sistemit të MFK-së, nëpërmjet:

- Paraqitjes së deklaratës së cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm sipas udhëzimit të Ministrise se Financave.
- Paraqitjes së Raportit Vjetor të cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm sipas udhëzimit të Ministrise se Financave.

8.Informimi dhe komunikimi:

Nje nga komponentet ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet në hartimin e PBA dhe P/Buxhetit

a).Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

- Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

b).E drejta e iniciativës qytetare

Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendim-marrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

- Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.
- Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Hartimi i kalendarit te programit buxhetor afatmesëm (PBA) dhe të buxhetit vjetor, përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë Kukës, pasi ky dokument:

- Përcakton dhe planifikon mekanizmat e nevojshem përmes të cilave, objektivat prioritare të identifikuar në programin e zhvillimit të njesise.
- Përcakton me hollësi afatet e procesit të menaxhimit të shpenzimeve publike.
- Ndihmon njesine në kryerjen e aktiviteteve të caktuara dhe arritjen e qëllimeve të përgjithshme për miratimin e PBA, buxhetit vjetor si dhe ndryshimeve të tij.

Ky kalendar mund të ndryshohet gjatë vitit financiar 2023, në rastet e kërkesave të rishikuara të programit buxhetor afat-mesëm (PBA 2024-2026) si dhe kërkesave shtesë të ndryshimit të buxhetit.

KALENDARI I AKTIVITETEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Dhjetor 2022	Brenda muajit Dhjetor 2022	Kryetari i NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026
Dhjetor 2022	Deri - 31 Dhjetor 2022	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Janar 2023	15	Kryetari i NJQV-së	Kryetari shpërndan kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese
Janar 2023	31	Kryetari i NJQV-së	Kryetari i njesisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve 2024-2026
Mars	1	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve PBA 2024-2026
Mars	Brenda dates 15	Kryetari i NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA 2024-2026
Mars	15	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026
Mars	20	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhezimin e përgatitjes së buxhetit të njesise vendore dhe e shpërndan tek njesite shpenzuese
Mars - Prill	21 Mars -25 Prill	Njesite shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Mars - Prill	26 Prill - 27 Prill	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2024-2026
Mars - Prill	29 Prill - 30 Prill	Njësitë shpenzuese të Bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura

Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	16 Maj - 26 Maj	Kryetari i NJQV-së	Organizon seancat dëgjimore me banorët
Maj	27 Maj - 29 Maj	Kryetari i NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2022-2024 me shoqërinë civile
Maj	30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Perpilon draftin e fazës së parë të PBA-së 2024-2026
Qershor	1	Kryetari i NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave	Dërgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri -25	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave
Qershor	Deri - 30	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	25	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese
Korrik - Gusht	26 Korrik-31 Gusht	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	1	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat buxhetore të rishikuara
Shtator	2 Shtator - 14 Shtator	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	Deri - 15	Kryetari i NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar
Shtator-Tetor	Deri 5 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverijes vendore
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA
Tetor-Nentor 2023	6 Tetor -30 Nentor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Përgatit P/Buxhetin e vitit 2024 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2024-2026 dhe i paraqet për shqyrtim në Këshill

Drejtori
Malig IMERAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 1/38 Prot.

L E N D A :

Verifikimi i Ligjshmërisë së Aktit.

Kukës më, 4 .01.2023

KRYETARIT TË BASHKISË

KËSHILLIT BASHKIAK

KUKËS

Bazuar në nenin 16, pika 2, shkronja “ b “ të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi verifikova kompetencën, juridiksionin dhe bazën ligjore të vendimit nr.82 të datës 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak Kukës :

V E N D O S A :

Të konfirmoj vendimin nr.82 të datës 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak Kukës :

Vendim nr.82; këshilli bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe bazuar në ligjin nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin nr.10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) , ligjin nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33, Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat-Mesem”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Vendimin e këshillit bashkiak Kukës nr.73 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023”, Udhëzimin Plotësues nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, Shkresës nr.19206 prot. datë 19.10.2022 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023” **mori vendim:**

1. Të miratojë Kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA 2024-2026) dhe të buxhetit vjetor 2024, bashkangjitur këtij Vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55/6, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

PREFEKTI

Ali Hallaçi

